Kronikë

17-vjeçarja në Vlorë tenton vetëvrasjen, nuk gjendet arma! Familja fsheh gjurmët, e mitura rëndë te Trauma

Një vajzë 17-vjeçare në Vlorë ka mbetur e plagosur në gjendje të rëndë si pasojë e një plage në kokë të shkaktuar nga arma e zjarrit. Ajo mbërriti e plagosur në spital. Policia e Vlorës zyrtarisht njofton se dyshohet që e mitura të jetë vetëplagosur me pistoletë.

Redaksia
14 Korrik, 13:11 | **Përditësimi: 14 Korrik, 23:29**

Share

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Kërko ndihmë

Një vajzë 17-vjeçare në Vlorë ka mbetur e plagosur në gjendje të rëndë si pasojë e një plage në kokë të shkaktuar nga arma e zjarrit. Ngjarja ka ndodhur sot pas mesditës, ndërsa arma e zjarrit ende nuk është gjetur. Pas ngjarjes, familjarët e kanë fshehur bashkë me gëzhojën dhe kanë pastruar vendngjarjen.

Sipas korrespondentit Armand Xhelili, e mitura ngaRomsi, u dërgua në spital nga vetë familjarët. Ajo mbërriti e plagosur në spital. Policia e Vlorës zyrtarisht njofton se dyshohet që e mitura të jetë vetëplagosur me pistoletë.

> *"Sot, rreth orës 11:40, është paraqitur në spital, në gjendje të rëndë shëndetësore, një shtetase e mitur 17 vjeçe, e cila dyshohet se është vetëplagosur me armë zjarri pistoletë, në banesën e saj, në lagjen "Kushtrimi". Grupi hetimor po punon për sqarimin e plotë të rrethanave të ngjarjes", bën të ditur policia.*

[Sh].com

LEXO EDHE:

Tre oficerë të Policisë Gjyqësore 'zbarkojnë' në Kadastrën e Vlorës! Hetime mbi lejen e dhënë për ndërtimin e një pallati! Disa apartamente u shitën disa herë

Pas marrjes së ndihmës së parë në Spitalin e Vlorës, 17-vjeçarja u nis për mjekim të specializuar drejt Spitalit të Traumës në Tiranë. Sipas bluzave të bardha, 17-vjeçarja ka qenë e vetëdijshme kur ka mbërritur në ambientet e Spitalit të Vlorës, por në momentin e parë ajo ka humbur ndjenjat dhe ka rënë në koma.

Sipas mjekëve, ka dy dëmtime në kokë; njëra prej të cilave tejshpuese. Sipas mjekëve, e mitura H.H është e intubuar. Ndërkohë që forca të shumta të policisë, por dhe drejtori i Policisë së Vlorës, kanë shoqëruar babain e vajzës. I ati e kundërshtoi shoqërimin e tij me forcë, pasi kërkonte që të shkonte në Tiranë për të shoqëruar vajzën e tij.

Sipas informacioneve, 17-vjeçarja ka qenë në shtëpinë e gjyshërve kur u plagos me armë në kokë në rrethana të paqarta. Policia ka nisur hetimet dhe po punon për të ndërtuar dinamikën dhe zbardhjen e ngjarjes së rëndë.

V.GJ /SI.E./Shqiptarja.com

TAG: tentative vetevrasje | plagosje ne vlore | Vlore

Komento

Komente

Demi: 14/07/2025 17:32

Keshtu do ta pesoje dhe ajo qorrja e lagjes Partizani ose i vellai plehre sapo te vije nga Italia.

Përgjigju

Alb: 14/07/2025 15:09

Ka tentuar vetëvrasje me 2 plumba? Si paska arritur të shkrepë armën për herë të dytë? Po armën ku e gjetë? Dhe si del policia duke thënë "dyshohet për vetëvrasje"? Të thonë që po hetohen të gjitha pistat. Nejse, ata e dinë më mirë. Ne thjesht opinione japim.

Përgjigju

Perspektive: 14/07/2025 13:50

Rinia shume e paperspektive ne Shqipëri , brezi 15-20 vjec /e sot ka nje problem nuk shikon arsimimin, trajnimet dhe teknologjine si model zhvillimi ! Cdo dite ky brez duket se ka nis nje modernizim negativ, sot Jane aferisjëtë 200-400 mije te rinj e ardhmja varet nga edukimi ketij brezi , si duhet te jete reforma per arsim, edukim i brezit te rI! Sot nje i ri me Moshe 18 vjec ne 2013 ishte vetem 6 vjec pra Jane produkt I reformave ne arsim pasi klasa e pare nis 6 vjec

Përgjigju

Erik: 14/07/2025 14:00

Me thuaj nje shtet pervec atyre te zhvilluara aziatike ku te rinjte dine se cfare do bejne me jeten e tyre pas 5-10 viteshi?! Gjithkund jane te perhumbur dhe te droguar nga Tiktok dhe IG, po rritet nje brez qe ne te gjeneratave te mehershme nuk po i kuptojme fare.

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH .COM

Sondazhi i ditës:
Nga sot sekuestro bulmetit pa faturë, si e vlerësoni?

14 Korrik, 08:45

Të drejtë | Të gabuar | Nuk kam mendim

Lajme të tjera

VIDEOLAJM/ I kërkuan kupon për peshqit, revoltohet peshkatari në Sarandë: Thojini Edit jam i pabindur, le të vijë vetë të më sekuestrojë mallin

14 Korrik, 13:34

Vlorë/ Rrezikoi jetën e pushuesve duke lundruar me gomone brenda perimetrit të sigurisë, gjobitet me 1 mln lekë drejtuesi

14 Korrik, 11:40

Shkeli lejen e ndërtimit, konfiskohet pallati i ish-drejtorit të Urbanistikës në Vlorë! Bici: Të njëjtin fat do kenë të gjithë abuzuesit (VIDEO)

Armand Xhelili

14 Korrik, 10:55

Anija 'Silver Whisper' ankorohet në portin e Vlorës, 383 pasagjerë nga SHBA-ja, Kanada-ja e Australia (VIDEO)

14 Korrik, 09:29

Rama: Sot do të bëhet një konfiskim i një pallati në Vlorë që është në shkelje të lejes së ndërtimit (VIDEO)

14 Korrik, 09:02

Arrestimi i 14 doganierëve grekë, radhë të gjata nga Greqia drejt Shqipërisë në doganën e Qafë Botës (VIDEO)

Limos Didani

13 Korrik, 14:34

Lirohen hapësirat publike të kthyera në parkim në Vlorë e Tiranë, aksion edhe në Golem! 3 në hetim (VIDEO)

13 Korrik, 12:47

Ndoti detin e Dhërmiut duke pastruar mjetin lundrues dhe shkeli perimetrin e sigurisë, në hetim drejtuesi! Gjobitet 100 mijë lekë pronari (VIDEO)

13 Korrik, 12:45

Dalin në dritë afresket e shekullit XIV-të në Kishën e Shën Kollit në Mesopotam, drejtuesja e projektit: Zbuluam fytyra shenjtorësh (FOTOT+VIDEO)

Limos Didani

13 Korrik, 10:21

Në linjën Vlorë-Brindisi do punojnë 2 tragete, fluks udhëtarësh në Port, 950 pasagjerë dhe 20 kampera turistësh vetëm sot! Shtohen sportelet (VIDEO)

Armand Xhelili

12 Korrik, 18:40

Vlorë/ Policia vijon aksionin për parkimet e gabuara, i largon mjetet me karrotrec! Kryepolici Çela paralajmëron edhe ndjekje penale për shkelësit (VIDEO)

Armand Xhelili

12 Korrik, 16:06

Aksioni për hapësirat publike në Vlorë, Rama ndan pamjet: Në Lungomare, një tjetër plazh publik i është rikthyer gytetarëve

12 Korrik, 12:23

© 2011 - 2025 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje